

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit
Programi:	Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri
Titulli i lëndës:	Mbrojtja dhe Siguria në Punë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi - ECTS:	4
Mësimdhënësi i lëndës:	Ligj. MSc. Bujar Jashari
Detajet kontaktuese:	bujar.jashari@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë lëndë do të elaborohen aspektet teorike të sigurisë në punë. Nga këtu lënda në fjalë qartëson sigurimin teknik në punë, sigurimin në fabrikat e prodhimit të lëndës së sharruar, stazhionuar dhe imprenjuar. Më pastaj do të përshkruhen siguritë në punë me materialet gjysmë fabrikate si: fabrikat që merren me përpunimin e produkteve gjysmë të gatshme.</p> <p>Përmes lëndës shpjegohet ergonomia në vendin e punës; Përdorimi i sigurt i makinave moderne CNC dhe makinave statike (tradicionale), shpjegohen rreziqet dhe masat mbrojtëse të punës gjatë operimit.</p> <p>Nga kjo lëndë elaborohen poashtu edhe shërbimet e sigurimeve ligjore dhe shërbimet profesionale nga aksidentet. Parimet ligjore në punë dhe shëndeti, standardet evropiane, operacionet e sigurisë dhe rregullat, ligji i punësimit dhe ligji i punës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Studentët duhet të kenë njohuri bazë të punës , të njihen më shumë me shëndetin dhe sigurinë në punë dhe në vendet e punës, për shembull:</p> <p>Aftësinë për të njohur kur ka aktivitete rreziku ashtu që të jenë të sigurtë në veprimet e tyre për të ndërmarrë masa parandaluese të sigurisë gjatë kryerjes së punëve të ndryshme në interior dhe eksterier.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lende, studentet do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Njohin parimet ligjore të punës; • Inspektojnë makinerinë në aspektin teknik; • Kuptojnë situatat e ndryshme të rrezikut të mundshëm nga faktorë të ndryshëm; • Organizojnë punë efektive operuesepa lëndime trupore; • Kuptojnë teknologjitë e përpunimit të materialeve. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	12	24
Kollokfiume,seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	3	3
Projektet,prezentimet, etj	2	3	6
Totali			101
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi do të realizohet përmes ligjëratave, ushtrimeve, shqyrtimeve, vizatimeve dhe projekttimeve ku do të marrin pjesë në mënyrë aktive të gjithë studentët. Do të realizohen simulime të ndryshme në laboratorin e Përpunimit të Drurit në Universitet.		
Metodat e vlerësimit:	Aktiviteti dhe puna e seminarit: 20 pike		

	Testi I: 40 Pikë Testi II: 40 Pike Gjithsej: 100 pikë
Literatura	
Literatura bazë:	1. Siguria në Punë në Industrinë e Drurit, Leka Gërdeshi, Botimet Kumi, Tiranë 2014; 2. Mbrojtja në punë dhe parandalimi i fatkeqësive. Ligjërata të autorizuar. Musli Bajraktari, Abdyl Koleci, Xhemajl Fejzullahu.
Literatura shtesë:	1. Rregullorja e mbrojtjes në punë dhe parandalimit të rreziqeve 2. Rregullorja e punës dhe mbrojtjes në punë nga çdo organizatë
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje
<i>Java e dytë:</i>	Aspektet teorike të sigurisë në punë
<i>Java e tretë:</i>	Vendndodhja e aksidenteve në punë në industrinë e drurit, bilanci human dhe ekonomik, aspektet juridike
<i>Java e katërt:</i>	Procedurat bazë të kryerjes së inspektimit në punë
<i>Java e pestë:</i>	Shkaqet e aksidenteve dhe dëmtimeve në punë
<i>Java e gjashtë:</i>	Bazat dhe parimet teknologjike për konstruktimin e pajisjeve, makinerive, dhe linjave teknologjike të përpunimit të drurit dhe materialeve ndihmëse për interior dhe eksterier
<i>Java e shtatë:</i>	Pajisjet mbrojtëse individuale të sigurisë në punë
<i>Java e tetë:</i>	Njohja me makinat e përpunimit primar të drurit dhe rreziqet në punë (Sharrat shirit, gaterët, makinat me disk prerës)
<i>Java e nëntë:</i>	Njohja me makinat e përpunimit sekondar të drurit dhe rreziqet në punë (plan drejtuesja, groseca, makina disk, frezat, makinat CNC)
<i>Java e dhjetë:</i>	Vazhdim, njohja me makinat e përpunimit sekondar të drurit dhe rreziqet në punë (plan drejtuesja, groseca, makina disk, frezat, makinat

	CNC)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Mbrojtja dhe pozicionimi (qëndrimi i trupit gjatë punës)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Prezentimi i punimeve seminarike nga ana e studentëve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Mbrojtja në punë nga zjarri
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Mbrojtja e punëtorit nga materialet ngjitesë, lustruese dhe zumparuese
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Mënyrat dhe rregullat e dhënies së ndihmës së shpejtë dhe ndihmës mjekësore
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<i>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>	